



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT  
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr. 5277 Prot.

Laç, me 23.09.2019

**V E N D I M - S H P A L L J E**

**(Lidhur me ekzekutimin e "Urdherit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)**

Ne Laç, sot me date 23.09.2019

Une, Mikeda Cenaj, me detyrë Përmbarues Gjyqësore pranë Zyres Përmbarimore Kurbin, pasi studiova aktet procedurale të çështjes përmbarimore Nr.425 rregjistri themeltar të vitit 2019 bazuar në Urdherin e ekzekutimit të datës 05.03.2019 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin,

**KONSTATOVA:**

Se në datë 20.03.2019 është depozituar pranë Zyres së Përmbarimit kërkesa e kreditorit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin së bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" të Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqësor penal) nr. 934-111 të datës 26.06.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me palë dhe objekt:

- Kreditor: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin
- Debitor: Vinçesk Luigj Pali i dtj. 09.05.1991 me banim në Lgj nr.2,100 ,Laç.
- Me objekt: Pagim shpenzime procedurale + tarifat fikse përmbarimore.

Nga ana e zyrë tone përmbarimore kanë filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Përmbarimor Gjyqësor" i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv të sipercituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone në bashkëpunim me organet kompetente rezultojnë se debitori Vinçesk Luigj Pali i dtj. 09.05.1991 nuk merr dijëni nepermjet sherbimit postar dhe si rezultat i kesaj bazuar në nenin 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 të K.Pr.Civile duhet të behet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ai ka ndaj palës kreditore Prokuroria Rr.Gj. Kurbin për shpenzimet procedurale dhe tarifat fikse përmbarimore në masën 4480 leke.

Sa me sipër në mbështetje të Nenit 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 të Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Përmbarimor Gjyqësor", i ndryshuar

**V E N D O S A**

1-Te kryej njoftimin nepermjet shpalljes publike me afat 20 (njetzet) ditor (duke mare parasysh edhe komunikimin postar) nga data 23/09/2019 - 12/10/2019 të debitorit Vinçesk Luigj Pali i dtj. 09.05.1991 me banim në Lgj nr.2,100 ,Laç .

2-Ky vendim perpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në vendbanimin e fundit të palës debitore, një kopje afishohet në kendin e njoftimeve të kesaj zyre, një kopje dergohet për afishim në ambientet e Bashkisë Kurbin, një kopje dergohet për afishim në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe një kopje i dergohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Tirane.

3-Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Vinçesk Luigj Pali i dtj. 09.05.1991 me banim në Lgj nr.2,100 ,Laç .

4-Pala debitore Vinçesk Luigj Pali i dtj. 09.05.1991 me banim në Lgj nr.2,100 ,Laç, duhet të paraqitet pranë Zyres Përmbarimore Kurbin me seli në Lgj nr.4, Laç në katin e parë në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe të marrë kontakt me përmbaruesin gjyqësor të çështjes përmbarimore për t'ju vene në dispozicion aktet përmbarimore, pasi me kalimin e ketij afati do të vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve të nenit 519 e në vijim të K.Pr.Civile.

U shpall, sot me date 23.09.2019.

**PERMBARUES GJYQËSOR  
MIKEDA CENAJ**

